



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 18. 02. 2010, në orën 13:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

**Mbledhjen e monitoruan:** Isuf Zejna – KDI, Violeta Rexha – EULEX, Nexhat Shatri - Zyra Presidentit, Lejla Selimi - OSBE .

**Nga Staf i Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj ,koordinator, Visar Krasniqi dhe Saranda Dushi – praktikante

**Mbledhjen e drejtoi: Ismet Beqiri.**

**Kryetari** konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10. 02. 2010,
3. Marrja e qëndrimit për organizimin e dëgjimit publik (tryezës): Shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje,
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10. 02. 2010**

*Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 10. 02. 2010.*

## **3. Marrja e qëndrimit për organizimin e dëgjimit publik (tryezës): Shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje**

**Kryetari** – I përshëndeti të pranishmit dhe monitoruesit e mbledhjeve të Komisionit. Ai në vija të trasha foli për detyrat që e presin Komisionin rreth organizimit të një tryeze, që i kushtohet Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje. Ai tha se ne e kemi mbështetjen rreth organizimit nga OSBE - ja dhe Komisionit i kanë ofruar ekspertë nga ODIHR – i. Gjithashtu, ceku se tryeza do të organizohet më 18. 03. 2010 në hotel “Grand“ në Prishtinë dhe do të ketë kohë të mjaftueshme për t’ i kryer punët tekniko - administrative nga Stafi Mbështetës i Komisionit.

**Ibrahim Makolli** - Kërkoj sqarim se a do të jetë dëgjim publik, apo tryezë (Works - shop)? Ai e mbështeti idenë e organizimit të tryezës, sepse ligji që shqyrtohet ka rëndësi të veçantë dhe përmban tri komponentë: parandalimin, rehabilitimin dhe sanksionimin.

**Hajredin Hyseni** - Në fillim ishte që të organizohet dëgjim publik, por pasi është njoftuar me përmbajtjen e tryezës, u pajtua që të organizohet tryeza, të cilën e konsideroi si më të efektshme.

**Drita Maliqi** - E mbështeti idenë e organizimit të work shopit dhe tha se do të ishte me inertes për Projektligjin. Ajo tha se versioni serbisht i Projektligjit ka të meta përmbajtjesore të cilat duhet të mënjanojnë gjatë amendamentimit.

**Luljeta Shehu** - Kërkoj të ftohen personat që kanë qenë viktimë e dhunës në familje. Ajo arsyetimin e mbështeti në interes që ta shohim se ku stagnon procedura e organeve të drejtësisë për procedimin e këtyre rasteve.

Pas diskutimeve konstruktive që u zhvilluan, Komisioni nxori këtë:

### **P e r f u n d i m**

*Komisioni, është pajtuar që më 18. 03. 2010, në orën 10: 30, në hotelin “Grand” në Prishtinë ta organizojë tryezën me temën: Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.*

Komisioni e miratoi regjistrin e subjekteve që do të ftohen në këtë tryezë.

## **4 Të ndryshme**

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit me shkresën nr. 03-3227 të datës 11. 02. 2010, me të cilën Instituti Demokratik (NDI) ka kërkuar identifikimin e disa ekspertëve që do të ofrojnë ekspertiza në fushat e caktuara.

**Ibrahim Makolli** – Komisionit ia propozoi këta emra: Zejnullah Grudën, Gazmend Nushin, Ali Bajgorën, Valon Muratin, Arieta Rexhën dhe Gjylbehare Muratin. Lista e emrave do t'i adresohet sekretarisë së Kuvendit, në mënyrë që të bëhet kompensimi i punën e bërë.

Komisioni diskutoi lidhur me vizitat studimore që kanë të bëjnë me Ligjin për personat e pagjetur.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 33

Kryetari i Komisionit

-----

Ismet Beqiri